



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.225/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.06.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me Nr.REF-58651-05-20-2020, me objekt “Ruajtja e godinës me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.320.436 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 01.06.2020, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Berat.

Ankimues: “Dea Security” shpk
Rruga: “Ndre Mjeda”, Qendra Polifunksionale, Kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Berat
Lagjia “Kushtrim”, Berat.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes.

II.1. Në datën 21.05.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-58651-05-20-2020, me objekt “Ruajtja e godinës me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.320.436 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 01.06.2020, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Berat.

II.2. Në datën 27.05.2020, operatori ekonomik “Dea Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, duke kundërshtuar kërkesat e dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

“Nepërmjet kesaj ankese duam te bejme prezent nje problem qe konsiston ne shkeljet e kryera nga Autoriteti Kontrator "Spitali Rajonal Berat", per proceduren e prokurimit parashikuar te zhvillohet date 01.06.2020 me objekt "Ruajtja e godines me roje private" -

Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara- me afat 12 muaj" si me poshte:

Nga ana e AK ne daten 21.05.2020 ne menyre elektronike jane publikuar kriteret kualifikuese per kete procedure prokurimi ne faqen e internetit te Agjencise se Prokurimit Publik dhe nje pjese te cilave i kundershtojme dhe kerkojme pezullimin dhe modifikimin e DST me arsyetimin paraqitur si me poshte:

1. AK duhet te modifikojë kërkesen ne DST te KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT per kapacitetin ligjor/professional, pika 4 citojme:

“4. Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat me afat një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për - Lista emërore e punonjësve të çertifikuar nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 10 (dhjete) punonjës shërbimi ku te kete te specifikuar daten e leshimit dhe daten e perfundimit - Të ketë qender kontrolli; - Të mos ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin për vitin 2019”.

AK duhet te heqe ose modifikojë kete kerkese pasi eshte kriter diskriminues dhe perjashtues, pasi koha e gjate, per te cilen kerkohet te mos kete mase administrative (per vitin 2019 dhe deri ne 01.06.2020 kur do te zhvillohet procedura eshte rreth 1 vit e gjysem), e kesaj kerkese mund te coje ne precedente per AK ne fazen e vleresimit, pasi prane nje subjekti mund te kete patur levizje te Titullarit dhe Drejtuesit Teknik, masa ndaj Drejtuesit dhe Titullarit te larguar, con dhe ne penalizimin e subjektit pa te drejte.

Nje Operator Ekonomik nuk mund te penalizohet per nje titullar dhe drejtues teknik i cili mund te kete qene me mase nga Drejtoria e Policise por qe aktualisht nuk eshte ne marredhenie pune me kete operator ekonomik, referuar kjo ekstraktit te QKB.

Qendrim te ngjashem mban edhe KPP me vendime te ngjashme nr. K.P.P.315/2019 date 27.05.2019, ku shprehet se "Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor nuk duhet te percaktojë kriteret diskriminuese dhe perjashtuese nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi. Konkretisht, ne lidhje me pretendimin e ngritur, gjykojme se , nie operator ekonomik nuk mund te penalizohet per nie titullar dhe drejtues teknik i cili mund te kete qene me mase nga Drejtoria e Policise por qe aktualisht nuk eshte ne marredhenie pune me kete operator ekonomik, referuar kjo ekstraktit te QKB."

Ne kerkojme qe Kriteri te modifikohet si me poshte:

4. Operatori ofertues duhet te paraqese vertetim performance nga Drejtoria Vendore e Policise Berat me afat nje muaj nga hapja e ofertave, ne te cilen te pasqyrohet informacioni per - Lista emërore e punonjësve të çertifikuar nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 10 (dhjete) punonjës shërbimi ku te kete te specifikuar daten e leshimit dhe daten e perfundimit - Të ketë qender

kontrolli; - Nuk duhet të ketë asnjë masë administrative për OE, titullarin dhe Drejtuesin teknik që k të punësuar dhe të deklarur në QKB në datën e hapjes së ofertave”.

Pra nga ana e AK duhet te hiqet ose te modifikohet kriteri per masen ne perputhje me percaktimet ligjore pasi nuk mund te penalizohet per nje titullar dhe drejtues teknik i cili mund te kete gene me mase nga Drejtoria e Policise por qe aktualisht nuk eshte ne marredhenie pune me kete operator ekonomik, referuar edhe qendrimeve te mbajtura nga ana e KPP cituar si me siper.

Perfundimisht nga Argumentimi i bere sa me siper kerkojme nga ana e

- Autoritetit tuaj heqjen ose modifikimin e kriterit ne dokumentat standarte te tenderit ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi”.*

II.3. Nëpërmjet shkresës nr. prot. 1854/1, datë 29.05.2020 autoritetit kontraktor i kthen përgjigje operatorit ekonomik “Dea Security” shpk, ku ka vendosur mospranim të ankesës.

II.4. Në datën 04.06.2020, operatori ekonomik “Dea Security” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si pranë AK-së.

II.5. Në datën 15.06.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 510/2 prot, shkresa e autoritetit kontraktor nr.2010 prot, date 12.06.2020, bashkëngjitur informacioni dhe dokumentacioni mbi hartimin e dokumentave të tenderit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” shpk për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “AK duhet te modifikojë kërkesen ne DST te KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT per kapacitetin ligjor/professional, pika 4 citojme: “4. Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat me afat një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për - Lista emërore e punonjësve të çertifikuar nënkategoria I.3.A për jo më pak se 10 (dhjete) punonjës shërbimi ku te kete te specifikuar daten e leshimit dhe daten e perfundimit - Të ketë qender kontrolli; - Të mos ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin për vitin 2019”. AK duhet te heqe ose modifikojë kete kerkese

pasi eshte kriter diskriminues dhe perjashtues, pasi koha e gjate, per te cilen kerkohet te mos kete mase administrative (per vitin 2019 dhe deri ne 01.06.2020 kur do te zhvillohet procedura eshte rreth 1 vit e gjysem), e kesaj kerkese mund te coje ne precedente per AK ne fazen e vleresimit, pasi prane nje subjekti mund te kete patur levizje te Titullarit dhe Drejtuesit Teknik, masa ndaj Drejtuesit dhe Titullarit te larguar, con dhe ne penalizimin e subjektit pa te drejte.

Nje Operator Ekonomik nuk mund te penalizohet per nje titullar dhe drejtues teknik i cili mund te kete qene me mase nga Drejtoria e Policise por qe aktualisht nuk eshte ne marredhenie pune me kete operator ekonomik, referuar kjo ekstraktit te QKB.Ne kerkojme qe Kriteri te modifikohet si me poshte:” 4. Operatori ofertues duhet te paraqese vertetim performance nga Drejtoria Vendore e Policise Berat me afat nje muaj nga hapja e ofertave, ne te cilen te pasqyrohet informacioni per - Lista emërore e punonjësve të çertifikuar nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 10 (dhjete) punonjës shërbimi ku te kete te specifikuar daten e leshimit dhe daten e perfundimit - Të ketë qender kontrolli; - Nuk duhet të ketë asnjë masë administrative për OE, titullarin dhe Drejtuesin teknik që ka të punësuar dhe të deklaruar nëQKB në datën e hapjes së ofertave”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 2.1. “Për kapacitetin ligjor/profesional”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “4. Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat me afat një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për - Lista emërore e punonjësve të çertifikuar nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 10 (dhjete) punonjës shërbimi ku te kete te specifikuar daten e leshimit dhe daten e perfundimit - Të ketë qender kontrolli; - Të mos ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin për vitin 2019”.

III.1.2. Në nenin 46 pika 1 të ligjit nr. 964. Datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet se “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmblusur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.

III.1.3. Në nenin 38 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.75/2014 dt.10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikohet se: “1.Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, kur ato nuk përbëjnë veprë penale, jepen masa administrative. 2.Masat administrative jepen nga strukturat e Policisë së Shtetit.”

III.1.4. Në kreun VIII “Masat Disiplinore dhe administrative”, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 parashikohet shprehimisht se: 1. Për shkeljet e dispozitave të ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, të cilat nuk përbejnë veprë penale, nga strukturat e Policisë së Shtetit jepen masat e mëposhtme administrative: a) Për subjektin e SHPSF-së: - vërejtje me paralajmërim për heqje të licencës; - heqje të licencës. b) Për titullarin e subjektit dhe drejtuesin

teknik: - vërejtje me paralajmërim për heqje të certifikatës; - heqje të certifikatës; - gjobë. c) Për punonjësin e shërbimit: - vërejtje; - vërejtje me paralajmërim për heqje të certifikatës; - heqje të certifikatës; - gjobë. 2. Dhënia e masave administrative, sipas neneve 40 dhe 41 të ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. 3. Dhënia e masave administrative, sipas neneve 42, 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, është kompetencë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë. 4. Për shkeljet e konstatuara gjatë kryerjes së shërbimit nga punonjësit e shërbimit, drejtuesi teknik ka të drejtë të japë për punonjësit e shërbimit masa disiplinore, sipas përcaktimit të bërë në kontratën e punës. Masat disiplinore të dhëna nga drejtuesi teknik administrohen në dokumentacionin e subjektit të SHPSF-së dhe raportohen në informacionet mujore, që dërgohen në drejtorinë e policisë vendore përkatëse. 5. Konstatimi dhe shqyrtimi i shkeljeve administrative bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative²⁸ 6. Procesverbali i konstatimit të shkeljes administrative, si dhe çdo dokumentacion tjetër, që është i vlefshëm gjatë fazës së shqyrtimit të shkeljes administrative, vihet në dispozicion sipas përkatësisë, strukturës përkatëse në Drejtorinë Vendore të Policisë. 7. Strukturat vendore të policisë, për rastet e shkeljeve të parashikuara në nenin 39, geramat “a” dhe “b” dhe në nenin 40, pika 1, të ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dërgojnë në KSHKCL në DPPSH, propozimet për masa administrative për çdo subjekt, vendimin e KSHKC-së, relacionin sqarues për masën që propozohet dhe procesverbalin e konstatimit. 8. Strukturat e shërbimit të të tretëve në DPPSH dhe DVP, sipas përkatësisë dhe kompetencës, bëjnë shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur për shkeljet e konstatuara dhe mbi këtë bazë relatojnë në KSHKCL”.

III.1.5. Në nenin 28 pika 2 “Kontratat e Shërbimeve” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.6. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, e për këtë arsye afati dhe kriteri i vendosur nga AK se “Të mos ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin për vitin 2019”, nuk përbën një kriter diskriminues dhe për më tepër nuk i tejkalon përmasat e kontratës së prokuruar. Është në të drejtën e autoritetit kontraktor që të vendosë të tilla kriterë ndalues për operatorët të cilët nuk kanë një performancë pozitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duke u ndëshkuar nga organet përkatëse me masa administrative për shkak të mospërmbushjes së rregullt të detyrimeve të caktuara që burojnë nga legjislacioni në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike apo nga akte të tjera ligjore e nënligjore. Komisioni gjykon se

kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit.

Pra sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-58651-05-20-2020, me objekt “Ruajtja e godinës me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.320.436 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 01.06.2020, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Berat.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 510 Protokoli, Datë 04.06.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar
Vilma Zhupaj**

**Anëtar
Lindita Skeja**

**Anëtar
Merita Zeqaj**

**Nënkryetar
Enkeleda Bega**

*